

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardijana Reshtani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit Y. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes të detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së. sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr. 1178/2016 të datës 06.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Sahide Sefa, dhe të akuzuarit, me datë 22.08.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

## I akuzuari:

Y. K., nga babai M. dhe e ëma Sh. e lindur D., i lindur me datë 07.11.1987 në Prizren, ku edhe jeton, rruga " ", nr. , ka të kryer shkollën fillore; furrta, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mirë ekonomike.

## ËSHTË FAJTOR

Se me datën 29.05.2016, rreth orës 00:40 minuta, në Prizren, saktësisht përball stacionit policor në rrugën " ", ka penguar personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor ishin duke kryer punën e tyre zyrtare, ndalojnë makinën " ", me targa të regjistrimit " ", të cilin ishte duke e vozitur i pandehuri i lartëcekur, gjatë kontrollimit dhe verifikimit të dokumenteve rezultoi se nuk kishte patent shoferi, policia i shqiptoi tikitën dhe të njëjtin e sugjeroi që të sigurojë një person me patent shoferi valid, i njëjti ndërmerr veprime duke ofenduar policët me fjalët "jeni bo si shkijet, mu sma ni k... për polic dhe se rruj për juve", e më pas e shtyen me forcë njërin nga zyrtarët policor dhe largohet nga vendi i ngjarjes, derisa në rrugën " ", patrulla policore arrijnë ta ndalojnë.

Këso dore ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes të detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.2, 45, 46, 47, 73, 74, 75, 76 dhe 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në dy kiste të barabarta dhe atë kistin e parë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishëmisë të aktgjykimit, ndërsa kistin e dytë në afat prej 30 ditësh pas pagesës së kistit të parë.



Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me dhunë, i njëjti do të zëvendësohet me denim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro, një ditë burg, respektivisht 15 ditë burg.

Dënimi me gjobë i cekur të akuzuarit i është shqiptuar si zëvendësim i dënimit me burgim, me pëlqimin e personit të dënuar, komform nenit 47 të KP-së, pasi që paraprakisht të njëjtin e dënoi me denim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, në të cilin denim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.05.2016 deri me date 16.06.2016,

Të dëmtuarit H. E. dhe A. M., zyrtar policor pranë stacionit policor në Prizren, për realizimin e kërkesës pronëso-ro-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1232/2016 të datës 06.06.2016, kundër të akuzuarit Y. K., nga P., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes të detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së.

Prokurori i shtetit Sahide Sefa, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr. 1232/2016 të datës 06.06.2016, kundër të akuzuarit Y. K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes të detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse i akuzuari në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysht të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysht pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë

I akuzuari Y. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj veprën penale cila më vihet në barë, unë në ditën kritike me datë 29.05.2016, rreth orës 00:40 minuta, kam qenë duke qarkulluar me automjet të markës Mercedes, me targa të regjistrimit C 793, dhe në momentin e cekur më ka ndalur patrulla e policisë, unë nuk i kam penguar të njëjtin në ushtrimin e detyrës, qëllimi i largimit tim nga vendi i ngjarjes ka qenë vetëm frika, mos po aplikojnë dhunë ndaj meje, unë lidhur me largimin pa leje të zyrtarëve policor nga vendi i ngjarjes e pranoj si shkelje të ligjit, por këtë e kam bërë nga fakti i cekur më lartë. Andaj i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, që jam përgjigjur në çdo ftesë të gjykatës, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin dhe faktin se pendohem thellë për veprën e kryer, dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesëshëm dhe të gjitha këto rrethanat i propozoj gjykatës që të merr si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.



Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 29.05.2016, rreth orës 00:40 minuta, në Prizren, i akuzuari saktësisht përball stacionit policor në rrugën "V... ..", ka penguar personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor ishin duke kryer punën e tyre zyrtare, ndalojnë makinën "V... ..", me targa të regjistrimit 07-...-BM, të cilin ishte duke e vozitur i pandehuri i lartëcekur, gjatë kontrollimit dhe verifikimit të dokumenteve rezultoi se nuk kishte patent shofer, policia i shqiptoi tiketën dhe të njëjtin e sugjeroi që të sigurojë një person me patent shoferi valid, i njëjti ndërmerr veprime duke ofenduar policët me fjalët "jeni bo si shkijet, mu sma ni k... për polic dhe se rruj për juve", e më pas e shtyen me forcë njërin nga zyrtarët policor dhe largohet nga vendi i ngjarjes, derisa në rrugën "V... ..", patrulla policore GAR - 1.1, arrijnë ta ndalojnë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se egzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuzën, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga nenin 409 par.5 lidhur me par.1 të KP-së. dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë, si zëvendësimin të dënimit të shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, komform nenin 47 të KP-së, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, shprehja e keqardhjes të akuzuarit për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, dënim i shqiptuar me gjobë është aplikuar komform nenin 47 të KP-së, si zëvendësim i dënimit të shqiptuar me burg paraprakisht dhe atë në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me pëlqimin e vetë të akuzuarit, pas shqyrtimit të të njëjtit, duke menduar se dënimin i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe shpenzimet mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarëve në kontestin e rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 par.1 të KPP-së

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1178/2016 me datë 22.08.2016**

**Procesmbjatesja**  
**Ardijana Reshtani,**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.